REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.

STRATI BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

**Nr. 5352**

**Nr. 3453 Prot.** **Tiranë, më 24.06.2022**

QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
Nr. 17641 Prot.
Datë 30.06.2022

**Drejtuar** : **Qendrës Kombëtare të Biznesit**

Për dijeni : **Shoqëria "PASHKASHESH" shpk**

*Adresa: Tiranë, Bërzhitë, linjë prodhimi inertesh, fshati Pashkashesh*

**ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A.**

Lënda : *Urdhër për heqjen e sekuestros*

Në Tiranë, sot më datë 24.06.2022,

Unë **Kozeta Guri,** përmbaruese gjyqësore private pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 83, datë Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Vendimit Nr. 4849, datë 04.11.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**KONSTATOVA:**

**S**e në datë 31.05.2022, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit Nr. 4849, datë 04.11.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

**K**reditor : ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A. (ish Telekom Albania Sh.A.)

**D**ebitor : Shoqëria "PASHKASHESH" shpk

**M**e Objekt : *Kthim shume*

**M**e Vendimin Nr. 4849, datë 04.11.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

*"Pranimin e kërkesë padisë.*
*Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "PASHKASHESH" shpk, t'i paguajë palës paditëse shoqërisë ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A., shumën 466,768 lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi celular.*
*Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur".*

**D**ebitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutim vullnetar dhe në kushtet ku debitori nuk mori masa për ekzekutimin e vendimit u urdhërua masa e sekuestros mbi aktivet e debitorit.

Sa më sipër, në kushtet kur debitori është duke shlyer detyrimin me pagesa të pjesshme, bazuar në K.Pr.Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 *"Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"*, Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë Nr. 2, datë 27.03.2014, *"Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka"* dhe Udhëzimit *"Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"*,

**URDHËROJ:**

1- **H**eqjen e masës së sekuestros në aktivet e palës debitore:

- **Shoqëria "PASHKASHESH" shpk me Nipt K51718007A,** *duke revokuar urdhërin tonë të mëparshëm.*

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**Përmbaruese Gjyqësore Private**

**Kozeta Guri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOZETA G. GURI PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT